



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1777/ 4 prot.

Datë 11.06.2026

V E N D I M
Nr. 789/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.06.2026 , shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve të Spitalit Sarandë” , me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Alstezo” SHA , me NIPT J63208420N dhe adresë: Zhupan Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulet monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.3. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29-05-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 05.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA me nr. 1777/2026 prot., datë 05.06.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6761, datë 05.06.2026 duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet SAE autoriteti kontraktor ka ngarkuar, shkresën nr.2770/6 prot., datë 09.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1777/1 prot., datë 10.06.2026, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Alstezo” sha, lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi. Bashkëngjitur shkresës së sipërpërmendur autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesës. Referuar vendimit të

KSHA rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar si me poshte [...] Në rastin konkret, KSHA gjykon se objekti i procedurës së prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të përdorura nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, automjete të cilat shërbejnë për realizimin e funksioneve të një institucioni shëndetësor publik. Për rrjedhojë, disponueshmëria në mënyrë të vazhdueshme si dhe funksionaliteti i tyre përbëjnë një element thelbësor dhe kyç për garantimin e vijimësisë së shërbimit shëndetësor ndaj qytetarëve dhe pacientëve. KSHA gjykon se kërkesa për disponimin e një ambienti servisi brenda Qarkut Vlorë është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin efektiv të kontratës dhe i shërben realizimit të qëllimit të Autoritetit Kontraktor Përfitues, i cili konsiston në:

- ndërhyrje të shpejtë në rastet e defekteve;
 - kryerjen në kohë të mirëmbajtjeve periodike;
 - minimizimin e kohës së nxjerrjes jashtë funksionit të automjeteve si dhe
 - shmangien e vonës që mund të cenon veprimtarinë e institucionit.
- KSHA verëson se përcaktimi i Qarkut Vlorë nuk është bërë në mënyrë rastësore, por lidhet drejtpërdrejt me vendndodhjen gjeografike dhe territorin ku operon dhe ushtron aktivitetin Autoriteti Kontraktor Përfitues. Pra Qarku Vlorë përfshin në vetvete Bashkinë Sarandë, çka nënkupton se ky kriter nuk është vendosur mbi bazën e një qarku të largët, por mbështetet mbi Njësinë Administrative ku ndodhet i pozicionuar gjeografikisht Autoriteti Kontraktor Përfitues. KSHA gjykon se përcaktimi i Qarkut Vlorë është objektiv, pasi përcaktimi i një qarku tjetër të ndryshëm, nuk do të kishte të njëjtën lidhje funksionale me objektin e prokurimit, e si rrjedhojë nuk do të përkonte me territorin ku zhvillohet aktiviteti i institucionit përfitues dhe ku përdoren automjetet që do të mirëmbahen. Në rastin konkret, Spitali Sarandë ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit administrativ të Qarkut Vlorë dhe automjetet objekt të kontratës përdoren në këtë territor për realizimin e funksioneve të institucionit. Gjithashtu, KSHA vlerëson se nuk mund të përcaktojë një rreze kilometrike apo një territor më të gjerë se Qarku Vlorë, për sa kohë kufiri territorial i zgjedhur është i arsyeshëm, objektiv dhe proporcional. Kërkesa nuk synon të favorizojë operatorë të caktuar ekonomikë, por të garantojë që shërbimi të ofrohet në një zonë gjeografike që mundëson reagim të shpejtë, kontroll efektiv të zbatimit të kontratës dhe minimizim të kohës së nxjerrjes jashtë funksionit të automjeteve.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sha. se: “[...]Ne 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient brenda Qarkut Vlorë ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve. Vendosija e kërkesës për disponimin e një ambienti autoservisi brenda Qarkut Vlorë kërkon sqarim dhe argumentim nga Autoriteti Kontraktor në raport me objektin e kontratës, parimin e proporcionalitetit dhe nxitjen e konkurrencës Kjo për faktin se kur themi Qarku

Vlore kemi te bejme me distanca shume here me te medha se sa nga AK Spitali Sarande ne Qarkun Fier, apo Qarkun Gjirokaster... Ne kete rast kerkojme sqarim nga AK se cfare qellimi ka kjo kerkese dhe ku eshte interesi ekonomik ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Nenin 77 te LPP, pasi ne rastin konkret kjo kërkesë nuk rezulton të jetë e argumentuar mbi baza objektive teknike apo ekonomike dhe nuk evidentohet lidhja e saj me nevojat konkrete të realizimit të kontratës. Nisur edhe nga eksperiencia qe ne kemi per riparimin e automjeteve per Spitalin Sarande, apo edhe ne cdo rast tjeter, kerkesa qe do te ndikonte ne faktorin kohe per kryerjen e shërbimit ne automjetet, pervec pergjigjes ne kohe reale nepermjet komunikimit te ndersjellte dhe rendimentit ne pune, eshte pikerisht shkurtimi apo percaktimi i distances, e cila eshte edhe ne raport me largesine nga AK. Ne kete rast nga ana e AK-se nuk eshte kerkuar ndonje kriter lidhur me piket apo prioritetin qe ka ne vleresim te ofertes nga AK sa i perket largesise se ambjentit te Auoservisit qe disponon OE ofertues Përcaktimi i detyrueshëm i ambientit brenda Qarkut Vlorë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë kapacitete teknike të mjaftueshme dhe që mund të ofrojnë shërbimin në mënyrë efikase, por që ushtrojnë aktivitetin në qarqe të tjera me distancë të barabartë ose edhe më të afërt me qytetin e Sarandës. Për rrjedhojë, kriteri rezulton potencialisht kufizues për konkurrencën dhe jo proporcional me objektin e kontratës. Me kete rast, theksojme faktin qe Shoqëria jonë ka realizuar me sukses shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje për automjetet e Spitalit Sarandë për një periudhë prej mbi katër vitet e fundit te aktivitetit te saj, duke respektuar afatet e nderhyrjes dhe realizimit shërbimit, cilësinë dhe kërkesat kontraktuale. Përvoja konkrete e zbatimit të këtyre kontratave demonstroi se elementi përcaktues për realizimin e shërbimi, nuk është përkatësia administrative e qarkut ku ndodhet ambienti i ushtrimit të aktivitetit, por aftësia reale për të garantuar realizimin efektiv te kontrates dhe ndërhyrje në kohë dhe përmbushje të detyrimeve kontraktore. Kriteri i vendosur krijon efekt përjashtues dhe trajtim të pabarabartë, duke kufizuar konkurrencën efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë që disponojnë kapacitete të plota teknike dhe profesionale, por që ushtrojnë aktivitetin jashtë Qarkut Vlorë Për më tepër, kriteri favorizon operatorët ekonomikë që disponojnë ambiente brenda Qarkut Vlorë pavarësisht largësisë reale nga Autoriteti Kontraktor, ndërsa përjashton operatorë ekonomikë që mund të ndodhen në distancë më të afërt dhe të ofrojnë të njëjtin ose një nivel më të lartë efikasiteti në realizimin e kontratës. Për rrjedhojë, kriteri cenon konkurrencën efektive dhe nuk respekton parimin e proporcionalitetit. Pra, në kushtet kur objekti i prokurimit është 'Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve të Spitalit Sarandë', kriteri i vendndodhjes administrative brenda një qarku të caktuar nuk garanton domosdoshmërisht një shërbim më të shpejtë ose më cilësor se sa operatorë ekonomikë të vendosur jashtë këtij qarku, por në distancë më të afërt nga Autoriteti Kontraktor. Vetë realizimi me sukses i kontratave të mëparshme për Spitalin Sarandë nga shoqëria jonë, si dhe fakti që aktualisht jemi në zbatim të Marrëveshjes Kuadër për të njëjtin autoritet kontraktor, demonstroi se përmbushja e detyrimeve kontraktore nuk ka qenë dhe nuk është e kushtëzuar nga vendndodhja administrative e aktivitetit, por nga kapacitetet teknike, profesionale dhe organizative të operatorit ekonomik. Përvoja konkrete e bashkëpunimit ndërmjet palëve provon se shërbimi është realizuar në mënyrë efektive, brenda afateve të kërkuara dhe në përputhje me kërkesat kontraktuale, pavarësisht faktit që aktiviteti i shoqërisë nuk ushtrohet brenda Qarkut Vlorë. Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor nuk ka shpjeguar dhe as nuk ka provuar me argumente objektive teknike apo ekonomike se përse një kriter i tillë territorial konsiderohet tashmë i domosdoshëm për realizimin e kontratës, ndërkohë që i njëjti operator ekonomik ka realizuar dhe po realizon me sukses të njëjtin

shërbim për të njëjtin përfitues, pa u evidentuar më parë asnjë problematikë që lidhet me vendndodhjen e aktivitetit. Për sa më sipër, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të shqyrtojë, saktësojë dhe modifikojë (riformulojë) kriteret e veçanta të kualifikimit Dokumenteve të Tenderit, në pikën 2.3.3 duke përcaktuar si kritere objektive, të matshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, si p.sh. një distancë maksimale nga selia e Spitalit Sarandë ose një afat maksimal reagimi për kryerjen e shërbimit, dhe jo kufizime të bazuara në ndarjen administrative territoriale, në mënyrë që procedura të zhvillohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.162/2020, dt.23/12/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK si edhe V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, i ndryshuar, si dhe me standardet e duhura teknike të fushës..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Ne shtojcën 9 pika 2.3.3 të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient brenda Qarkut Vlorë ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontrates..

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.8.2. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, shprehimisht thuhet se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Neni 40, pika 3 dhe 5, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

5. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponimin e një ambienti autoservisi brenda Qarkut Vlorë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një përcaktim i tillë i bërë nga autoriteti kontraktor është diskriminues Për autoritetin kontraktor e rëndësishme sipas kthim pergjigjes “KSHA gjykon se

kürkesa per disponimin e një ambienti servisi brenda Qarkut Vlore është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin efektiv të kontratës dhe i shërben realizimit të qëllimit të Autoritetit Kontraktor Përfitues, i cili konsiston në:

- ndërhyrje te shpejtë në rastet e defekteve;*
 - kryerjen ne kohë të mirëmbajtjeve periodike;*
 - minimizimin e kohës se nxjerrjes jashte funksionit të automjeteve si dhe*
 - shmangien e vonesave që mund të cenojnë veprimtarinë e institucionit.*
- KSHA verëson se percaktimi i Qarkut Vlorë nuk është bërë në mënyrë rastesore, por lidhet drejtpërdrejt me vendndodhjen gjeografike dhe territorin ku operon dhe ushtron aktivitetin Autoriteti Kontraktor Përfitues. Pra Qarku Vlorë përfshin në vetvete Bashkinë Sarandë, çka nënkupton se ky kriter nuk është vendosur mbi bazën e një qarku të largët, por mbështetet mbi Njësinë Administrative ku ndodhet i pozicionuar gjeografikisht Autoriteti Kontraktor Përfitues. KSHA gjykon se përcaktimi i Qarkut Vlorë është objektiv, pasi përcaktimi i një qarku tjetër të ndryshëm, nuk do të kishte të njëjtën lidhje funksionale me objektin e prokurimit, e si rrjedhojë nuk do të përkonte me territorin ku zhvillohet aktiviteti i institucionit përfitues dhe ku përdoren automjetet që do të mirëmbahen. Në rastin konkret, Spitali Sarandë ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit administrativ të Qarkut Vlorë dhe automjetet objekt të kontratës përdoren në këtë territor për realizimin e funksioneve te institucionit.*

KPP shprehet se kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor, sipas te cilit operatori ekonomik duhet te disponoje servis ne Qarkun Vlore, paraqet elemente te qarte kufizues te konkurrences dhe nuk rezulton te jete ne përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabarte te operatoreve ekonomike. Autoriteti Kontraktor e justifikon kete kerkese me nevojën qe servisi te jete prane vendit ku eshte vendodhja e autotietit, me qellim minimizimin e kohes, nderhyrje te shpejte ne rastet e defekteve etj. Megjithate, ky objektiv mund te arrihet permes kriterëve me objektive dhe me pak kufizuese sesa kufizimi territorial brenda nje qarku te caktuar. Ne kete rast, nuk eshte vendndodhja administrative e servisit ajo qe garanton cilesine dhe shpejtesine e sherbimit, por distanca reale dhe koha e reagimit ndaj nevojave te Autoritetit Kontraktor. Kufizimi vetem ne Qarkun Vlore perjashton pa arsye objektive operatorë ekonomikë që mund të disponojnë servise në qytete të tjera, jashte qarkut Vlore të cilët janë plotësisht të aftë të ofrojnë të njëjtin nivel shërbimi ose edhe më të favorshëm për Autoritetin Kontraktor. Pra një operator me servis jashte qarkut Vlore mund të garantojë ndërhyrje dhe riparim brenda afateve të kërkuara, ndërsa përjashtohet vetëm për shkak të vendndodhjes administrative të servisit. Një kufizim i tillë nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë teknike të operatorit për të realizuar kontratën. Gjithashtu, vetë fakti që kërkohet servis në Qarkun Vlorë nuk garanton domosdoshmerisht afersine me Saranden. Qarku Vlore perfshin nje territor te gjere dhe nje servis i vendosur ne nje zone te caktuar te qarkut mund te jete ne praktike me larg nga Saranda sesa nje servis i ndodhur ne nje qark tjetër apo qytet tjetër. Per rrjedhoje, kriteri i referuar kufijve administrative nuk perben nje tregues real te afersise dhe as nuk siguron realizimin e qellimit te pretenduar nga Autoriteti Kontraktor. Ne zbatim te parimit te proporcionalitetit, Autoriteti Kontraktor duhet te vendose kriterë qe jane te nevojshme dhe te pershtatshme per arritjen e objektivit te kontrates, pa kufizuar padrejtesisht konkurrencen. Ne vend te kerkeses per servis brenda Qarkut Vlore, do te ishte me e arsyeshme dhe me ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik te kerkohej qe operatori ekonomik te disponoje servis ose pike sherbimi brenda nje distance te caktuar nga Saranda, ose te garantoje nje kohe maksimale reagimi dhe nderhyrjeje per riparimin e ambulancave. Per sa me siper, kerkesa per disponimin e servisit vetem ne Qarkun Vlore konsiderohet një kriter kufizues per konkurrencën, pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që mund te permbushin ne

menyre te barabarte nevojat e Autoritetit Kontraktor. Per rrjedhoje, ky kriter duhet te riformulohet ne menyre qe te lidhet me distancen ose kohen e reagimit ndaj sherbimit dhe jo me kufij administrative qe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin efektiv të kontratës. Te modifikohet pa cenuar realizimin me sukses dhe cilesine e ofrimit te ketij sherbimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet dhe arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti Kontraktor, brenda 5 diteve të verë në dënim Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nenkryetar
Fiorent Zguro

